



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË RAPORTIMIT PERIODIK TË
SHOQËRIVE KOMISIONERE, BANKAVE QË OFROJNË SHËRBIME INVESTIMI NË
TITUJ DHE INSTITUCIONEVE TË TREGUT

Miratuar me Vendim Bordi nr. 197, datë 24.11.2023

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe afateve kohore të raportimit periodik të të dhënave lidhur me veprimtarinë e shoqërive komisionere, bankave që ofrojnë shërbime investimi në tituj dhe institucioneve të tregut, pranë Autoritetit, në funksion të marrjes së informacionit të standardizuar nga subjektet raportuese për efekt të mbikëqyrjes së tregut dhe statistikave.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të shkronjës “dh”, të nenit 8, shkronjës “l”, të nenit 48, neneve 105, 107, 129, si dhe pikave 3 dhe 8, të nenit 154, të ligjit nr. 62, datë 14.5.2020 “Për tregjet e kapitalit”, këtu e më poshtë “ligji”.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për shoqëritë komisionere, bankat, si dhe institucionet e tregut, të përkufizuara sipas përcaktimit të pikës 60, të nenit 3 të ligjit, të cilat konsiderohen subjekte raportuese për qëllim të kësaj rregulloreje, të licencuara, regjistruara dhe njohura nga Autoriteti dhe që ofrojnë veprimtari të rregulluar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën përkatëse.

Neni 4

Komunikimi me Autoritetin

1. Shoqëritë komisionere dhe institucionet e tregut depozitojnë pranë Autoritetit pasqyrat financiare vjetore të certifikuara nga një auditues ligjor i miratuar.
2. Shoqëritë komisionere, bankat që ofrojnë shërbime investimi në tituj dhe institucionet e tregut depozitojnë pranë Autoritetit informacione dhe raporte të tjera periodike, të kërkuara nga ligji dhe kjo rregullore.
3. Në funksion të ushtrimit të mbikëqyrjes Autoriteti mund t'i kërkojë subjekteve raportuese, çdo informacion dhe dokument që ka lidhje me veprimtarinë e tyre.
4. Subjektet raportuese janë të detyruar t'i vënë në dispozicion Autoritetit çdo dokument të kërkuar, sipas ligjit dhe kësaj rregulloreje.
5. Subjektet raportuese duhet të kenë të gjithë mjetet apo mekanizmat e nevojshme që sigurojnë raportimin e plotë të transaksioneve dhe informacionit të kërkuar në Autoritet.

Neni 5

Raportimi i pasqyrave financiare

1. Shoqëritë komisionere dhe institucionet e tregut përgatisin çdo vit kalendarik pasqyrat financiare dhe i paraqesin ato në Autoritet, brenda 4 (katër) muajve nga data e mbylljes së vitit ushtrimor.
2. Kur shoqëritë komisionere janë shoqëri pjesë e një grupi (tip holding) ose shoqëri të kontrolluara, përgatisin pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara të audituara për të gjithë grupin, sipas mënyrës së parashikuar në rregullat për kontabilitetin e shoqërive tregtare dhe në zbatim të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, dhe i depozitojnë ato në Autoritet, brenda 4 (katër) muajve, nga data e mbylljes së vitit ushtrimor.
3. Shoqëritë komisionere dhe institucionet e tregut mbajnë llogaritë dhe hartojnë pasqyrat financiare vjetore, si pjesë të raportit vjetor, në përputhje me ligjin në fuqi për tregjet e kapitalit, me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe me rregullat e aktet e tjera nënligjore, që rregullojnë kontabilitetin e shoqërive tregtare dhe zbatimin e standardeve të raportimit financiar.
4. Shoqëritë komisionere dhe institucionet e tregut i mbajnë llogaritë dhe i hartojnë pasqyrat financiare vjetore në atë mënyrë që mundësojnë verifikimin e ngjarjeve të regjistruara tregtare, pozicionin e tyre financiar dhe performancën e veprimtarisë së tyre tregtare.
5. Shoqëritë komisionere dhe institucionet e tregut hartojnë pasqyrat financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

Neni 6

Forma dhe përmbajtja e pasqyrave financiare

1. Pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë komisionere dhe institucionit të tregut duhet të përfshijnë:
 - a) Pasqyrën e pozicionit financiar, ku jepet një pamje e drejtë dhe e vërtetë e situatës së shoqërisë komisionere, siç është në mbyllje të vitit ushtrimor;
 - b) Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, ku jepet një pamje e drejtë dhe e vërtetë e fitimit ose e humbjes së shoqërisë komisionere/institucionit të tregut për vitin ushtrimor;
 - c) Pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin aksionar;
 - ç) Pasqyrën e flukseve monetare; dhe
 - d) Një përshkrim të politikave kontabël, që ka zbatuar shoqëria komisionere/institucioni i tregut gjatë hartimit të pasqyrave financiare.
2. Shoqëria komisionere, përgatit pasqyrën vjetore të të ardhurave gjithëpërfshirëse sipas formës dhe përmbajtjes të përcaktuar në Shtojcën 6 të kësaj rregulloreje.

Neni 7

Raportimi ditor i transaksioneve nga shoqëritë komisionere dhe bankat që ofrojnë shërbime investimi

1. Përveçse sa është parashikuar në ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, shoqëritë komisionere dhe bankat që kryejnë transaksione në tituj duhet të raportojnë në Autoritet detaje të plota dhe të sakta të këtyre transaksioneve sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se fundi i ditës tjetër të punës.
2. Transaksionet me tituj të Qeverisë Shqiptare duhet të raportohen përmes platformës, të administruar nga Autoriteti.
3. Transaksionet që kryhen në tregun e rregulluar/Bursë, PSHT, POT apo jashtë një tregu të rregulluar raportohen në Autoritet në rrugë elektronike, sipas Shtojcës 2/1 të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Raportimi periodik i transaksioneve nga Tregu i rregulluar/Bursa, PSHT apo POT

1. Tregu i rregulluar/Bursa, PSHT, POT depoziton në Autoritet një raport ditor, i cili përmban të dhëna për transaksionet me tituj të kryera në tregun përkatës, sipas Shtojcës 2/2 të kësaj rregulloreje në rrugë elektronike.
2. Tregu i rregulluar/Bursa i mundëson Autoritetit akses në sistemin e tregtimit në kohë reale.
3. Tregu i rregulluar/Bursa i raporton çdo muaj Autoritetit transaksionet e kryera nga anëtarët e këshillit të administrimit/ këshillit mbikëqyrës dhe funksionarët kryesorë të tregut të rregulluar/bursës.

Neni 9

Raportet për qëllime mbikëqyrje dhe/apo statistikore

1. Subjektet raportuese janë përgjegjëse për hartimin dhe depozitimin e të dhënave lidhur me veprimtarinë për qëllime mbikëqyrje dhe/apo statistikore.
2. Përmbajtja dhe forma e raporteve statistikore të shoqërive komisionere dhe bankave që kryejnë shërbime investimi, përcaktohet në Shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.
3. Përmbajtja dhe forma e raporteve të tregut të rregulluar/ Bursës, përcaktohet në Shtojcën 4 të kësaj rregulloreje.
4. Përmbajtja dhe forma e raporteve mbi veprimtarinë e Depozitarit Qendror, përcaktohet në Shtojcën 5 të kësaj rregulloreje.

Neni 10

Periodiciteti, afati dhe mënyra e raportimit

1. Përveç kur parashikohet ndryshe, raportimet sipas shtojcave të përcaktuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje kryhen me një frekuencë 3 (tre) mujore nga shoqëritë komisionere, bankat dhe institucionet e tregut.
2. Shoqëritë komisionere dhe bankat raportojnë transaksionet e kryera me titujt e Qeverisë jashtë tregut të rregulluar/Bursës me periodicitet 1 (një) mujor.
3. Subjektet raportuese raportojnë në Autoritet informacionin e kërkuar brenda 10 (dhjetë) ditë pune pas mbylljes së çdo periudhe raportuese.
4. Te dhënat e kërkuara sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje raportohen nga subjekti në formë shkresore.

Neni 11

Përgjegjësia për saktësinë e informacionit dhe korrigjimi i gabimeve në raportim

1. Subjektet raportuese janë përgjegjëse për saktësinë e të dhënave të raportuara prej tyre.
2. Nëse subjektet raportuese identifikojnë pasaktësi në të dhënat e raportuara pas dërgimit të tyre në Autoritet, ato janë të detyruara të njoftojnë menjëherë, duke kryer korrigjimet e duhura.
3. Nëse Autoriteti konstaton se të dhënat e raportuara janë të pasakta, kërkon nga subjekti përkatës raportues korrigjimin e tyre dhe përsëritjen e raportimit pas korrigjimeve. Subjektet raportuese kryejnë korrigjimet dhe i raportojnë ato brenda ditës pasardhëse të punës.
4. Për çdo gabim të konstatuar apo mangësi në raportim, subjekti raportues duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin sipas formatit në Shtojcën 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 12
Sekreti profesional

Punonjësit e Autoritetit të cilët kanë për detyrë funksionale administrimin e raportimeve periodike të subjekteve raportuese, janë përgjegjës për ruajtjen e sekretit profesional, në përputhje me përcaktimet e rregullores “Për konfidencialitetin në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

Neni 13
Masat ndëshkimore

Në zbatim të ligjit nr. 62/2020, datë 14.5.2020 “Për tregjet e kapitalit” dhe ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Autoriteti, në rast të mosrespektimit të dispozitave të kësaj rregulloreje merr masa administrative ndaj subjekteve raportuese.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2024

SHTOJCA 1: Raport statistikor i shoqërive komisionere dhe bankave që kryejnë shërbime investimi

Informacion i përgjithshëm për Subjektin Raportues (shoqëri komisionere/banka)

Periudha raportuese: _____

Data: _____

1.	Emri i Subjektit	
2.	Lloji dhe nr. i Licencës	
3.	Adresa postare	
4.	Adresa e-mail	
5.	Website	
6.	Lloji i Raportimit	
7.	Monedha raportuese	

Shënim: Kjo tabelë shoqëron çdo raportim mujor apo 3-mujor.

SHTOJCA 1/1**Raportim për shërbimet e investimit të ofruara nga subjekti për periudhën raportuese - (3 mujore)**

Lloji i shërbimit të investimit të ofruar	Shëno me “X”	Lloji i shërbimit ndihmës të ofruar	Shëno me “X”
1. Marrja dhe transmetimi i urdhrave për një ose më shumë instrumente financiare		1. Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve	
2. Ekzekutimi i urdhrave në emër të klientëve		2. Dhënia e kredive ose e huave një investitori për t'i dhënë mundësi të kryejë një transaksion me një ose më shumë instrumente financiare, ku shoqëria që jep kredinë ose huan, ose një subjekt tjetër i lidhur me të, është e përfshirë në transaksion	
3. Tregtimi për llogari të vet		3. Këshillimi i shoqërive tregtare në lidhje me strukturën e kapitalit, strategjinë industriale dhe çështjet e lidhura me to, këshillimi e ofrimi i shërbimeve për bashkimin dhe blerjen e shoqërive tregtare	
4. Administrimi i portofolit		4. Shërbimet e këmbimit valutor kur këto janë të lidhura me ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj	
5. Këshillimi dhe dhënia e rekomandimeve për investime		5. Identifikimi i investimeve dhe kryerja e analizave financiare lidhur me to ose ofrimi i formave të tjera të rekomandimeve të përgjithshme në lidhje me transaksionet me instrumente financiare	

<p>6. Nënshkrimi i instrumenteve financiare dhe/ose hedhja në treg e instrumenteve financiare në bazë të angazhimit në transaksion</p>		<p>6. Shërbimet e lidhura me dhënien e angazhimeve për blerjen e titujve</p>	
<p>7. Hedhja në treg e instrumenteve financiare pa angazhim shitjeje</p>		<p>7. Shërbimet dhe veprimtaritë e investimit në tituj, si edhe shërbimet ndihmëse të lidhura me instrumentet derivative kur këto janë të lidhura me ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj ose shërbimeve të tjera ndihmëse</p>	
<p>8. Operimi i një platforme shumëpalëshe tregtimi</p>			
<p>9. Operimi i një platforme të organizuar tregtimi</p>			

SHTOJCA 1/2

Raportim për shërbimin e marrjes, transmetimit dhe ekzekutimit të urdhrave

Raportim mujor për transaksionet me Titujt e Qeverisë së RSH

Për [muajin] [vitin]

	Lloji I transaksionit	Bono (sipas maturimit)		Obligacion (sipas maturimit)	
		Volumi i transaksioneve	Nr. i Transaksioneve	Volumi i transaksioneve	Nr. i Transaksioneve
A	Marrje dhe Transmetim urdhri në tregun primar (Ankand)				
A1	<i>Klientë joprofesionistë (Individë)</i>				
A2	<i>Klientë joprofesionistë (persona juridikë)</i>				
A3	<i>Klientë profesionistë/palë e pranueshme/klient i kualifikuar</i>				
B	Tregtim për llogari të vet kur ekzekuton urdhrat e klientit (Shitja e titujve të Qeverisë investitorit nga portofoli i bankës, apo shoqërisë komisionere)				

B1	<i>Klientë joprofesionistë (Individë)</i>				
B2	<i>Klientë joprofesionistë (persona juridikë)</i>				
B3	<i>Klientë profesionistë/palë e pranueshme/klient i kualifikuar</i>				
C	Tregtim për llogari të vet kur ekzekuton urdhrat e klientit (Blerja e titujve të Qeverisë nga banka apo shoqëria komisionere para datës së maturimit nga investitori)				
C1	<i>Klientë joprofesionistë (Individë)</i>				
C2	<i>Klientë joprofesionistë (persona juridikë)</i>				
C3	<i>Klientë profesionistë/palë e pranueshme/klient i kualifikuar</i>				
D	Vendosja si kolateral				
D1	<i>Klientë joprofesionistë (Individë)</i>				
D2	<i>Klientë joprofesionistë (persona juridikë)</i>				
D3	<i>Klientë profesionistë/palë e pranueshme/klient i kualifikuar</i>				

E	Shlyerja e vlerës nominale në datën e maturimit				
E1	<i>Klientë joprofesionistë (Individë)</i>				
E2	<i>Klientë joprofesionistë (persona juridikë)</i>				
E3	<i>Klientë profesionistë/palë e pranueshme/klient i kualifikuar</i>				
F	Ekzekutimi i urdhrit të klientit (jo nga dhe për llogari të portofolit të subjektit)				
F1	<i>Klientë joprofesionistë (Individë)</i>				
F2	<i>Klientë joprofesionistë (persona juridikë)</i>				
F3	<i>Klientë profesionistë/palë e pranueshme/klient i kualifikuar</i>				

Shënim: Raportimi sipas kësaj tablele nuk përfshin transaksionet ndërbankare, si dhe transaksionet me Eurobondin shqiptar.

SHTOJCA 1/3

Raportim 3 mujor për transaksionet që realizohen në treg të rregulluar/Bursë/PSHT/POT si dhe transaksionet me tituj te ndryshëm nga titujt e Qeverisë së RSH jashtë një tregu të rregulluar (OTC), përfshirë transaksionet me tituj të huaj, si dhe eurobondin shqiptar

Lloji i instrumentit financiar (IF)	Vëllimi i transaksioneve	Nr.i klientëve gjithsej	Nr. i klientëve sipas kategorizimit						Nr. i klientëve sipas shtetit të rezidencës së Klientit		
			Investitorë Jo - profesionistë		Palë e pranueshme			Investitorë të tjerë profesionistë	Investitorë të kualifikuar	Rezident	Jo Rezident
IF-1											
IF-2			Individë	Persona juridikë	Fonde pensioni	Fonde investimi	Shoqëri sigurimi				
IF-3											
IF-X											
Total											

Shënim: Në këtë raportim nuk përfshihen transaksionet ndërbankare.

SHTOJCA 1/4

Raportim 3 mujor për shërbimet e investimit online

Emërtimi i platformës	
Numri i klientëve që kanë investuar në platformë (total)	
Numri i klientëve “jo-profesionistë” që kanë investuar në platformë	
Numri i klientëve “profesionistë” që kanë investuar në platformë	
Numri i klientëve “palë e pranueshme” që kanë investuar në platformë	
Numri i klientëve “të kualifikuar” që kanë investuar në platformë	
Nënkujdestari	
Intervali i levës financiare të përdorur nga klientët për periudhën raportuese	
Asetet nën menaxhim (AUM total)	
Asetet nën menaxhim, mesatare/klient (AUM mesatare/klient)	
Fondet e investuara në platformë (funds in)	
Fondet e tërhequra nga platforma (funds out)	
Fondet e netuara (net funds)	

Fitimi/humbja totale e realizuar nga klientët	
Fitimi/humbja e porealizuar nga klientët	
Përqindja e humbjes së klientëve në produktet me marzh	
Përqindja e humbjes së klientëve në të gjithë produktet	
Shuma maksimale e lejuar e tërheqjes (nëse ka)	
Numri i llogarive të mbyllura nga klientët	

Numri dhe vlera e transaksioneve të kryera në platformë sipas instrumentit financiar për periudhën raportuese

<i>Instrumentet financiare</i>	Kontratat e së ardhmes (Futures)	FOREX	CFD	Aksione	Obligacione	Tjetër
Numri i transaksioneve						
Vlera e transaksioneve						

SHTOJCA 1/5

Raportim 3 mujor për shërbimin ndihmës të ruajtjes dhe administrimit të instrumenteve financiare (shërbimi i kujdestarisë) për të gjithë llojet e titujve (titujt e Qeverisë së RSH, eurobondi shqiptar dhe titujt e huaj)

Lloji i instrumentit financiar (IF)	Gjendja e aseteve të klientëve (në vlerë monetare)	Nr.i klientëve gjithsej	Nr. i klientëve sipas kategorizimit						Nr. i klientëve sipas shtetit të rezidencës së Klientit		
			Investitorë Jo - profesionistë		Palë e pranueshme			Investitorë të tjerë profesionistë	Investitorë të kualifikuar	Rezident	Jo Rezident
IF-1											
IF-2			Individë	Persona juridikë	Fonde pensioni	Fonde investimi	Shoqëri sigurimi				
IF-3											
IF-X											
Total											

Raportim 3 mujor për shërbimin e kujdestarisë lidhur me obligacionet e emetuara me ofertë private dhe publike

Emetues	Kodi ISIN	Viti i Emetimit	Gjendja e pashlyer sipas monedhës			Emetim me oferte private apo publike	Numri i klientëve		
			ALL	EUR	USD		Jo-profesionist (individ)	Profesionist	Personatë tjerë juridikë
Emetuesi 1 [Emri i subjektit]									
Emetimi 1									
Emetimi 2									
Emetimi X									
Total Emetuesi 1									
Emetuesi 2 [Emri i subjektit]									
Emetimi 1									
Emetimi 2									
Emetimi X									
Total Emetuesi 2									

Total të gjithë Emetuesit							
----------------------------------	--	--	--	--	--	--	--

SHTOJCA 1/6

Raportim 3 mujor i ankesave të klientëve

Raportimi i Ankesave						
1 - Numri i Ankesave sipas shkakut		Numri i ankesave të reja të pranuar gjatë 3 mujorit raportues				Numri i ankesave të pazgjidhura nga 3 mujorët e mëparshëm raportues
		Nga klientë brenda territorit të Shqipërisë	Nga klientë brenda territorit të BE-së	Nga klientë jashtë territorit të BE-së dhe Shqipërisë	Numri total i ankesave të pranuar gjatë periudhës aktuale raportuese	
Ekzekutimi i urdhrave në emër të klientëve/ marrja dhe transmetimi i urdhrave për një ose më shumë instrumente financiare	Cilësia ose mungesa e informacionit të ofruar për klientin					
	Mungesa e përshtatshmërisë për klientin					
	Kushtet e kontratës / tarifat					
	Për shërbimet në përgjithësi (përfshirë shërbimet e kujdestarisë)					
	Probleme në lidhje me tërheqjen e fondeve të investitorëve					

	Të tjera, nga të cilat:					
	Ekzekutim i pasaktë i urdhërit / Urdhër tregtimi jo i nxitur					
	Probleme në lidhje me rënien e çmimeve					
	Probleme që lidhen me platformën e tregtimit					
	Probleme në pagesa (dividend/kupon, etj)					
	Asnjë nga më sipër (ju lutemi specifikoni në seksionin e komenteve më poshtë)					
Administrimi i Portofolit	Cilësia ose mungesa e informacionit të ofruar për klientin					
	Mungesa e përshtatshmërisë për klientin					
	Kushtet e kontratës / tarifat					
	Për shërbimet në përgjithësi (përfshirë shërbimet e kujdestarisë)					
	Probleme në lidhje me tërheqjen e fondeve të investitorëve					
	Të tjera (ju lutemi specifikoni në seksionin e komenteve më poshtë)					
Këshillimi dhe dhënia e rekomandimeve për investime	Cilësia ose mungesa e informacionit të ofruar për klientin					
	Mungesa e përshtatshmërisë për klientin					
	Kushtet e kontratës / tarifat					

	Për shërbimet në përgjithësi (përfshirë shërbimet e kujdestarisë)					
	Probleme në lidhje me tërheqjen e fondeve të investitorëve					
	Të tjera (ju lutemi specifikoni në seksionin e komenteve më poshtë)					
	Të tjera, nga të cilat:					
Totali i ankesave						
Ju lutemi jepni informacion për të gjitha ankesat e raportuara në seksionet "Tjetër" ose "Asnjë nga sa më sipër", dhe përfshini çdo informacion që mund të ndihmojë në shpjegimin e shifrave/të dhënave.						
2 -Numri i ankesave sipas instrumenteve financiare	Numri i ankesave të reja të pranuar gjatë 3 mujorit aktual raportues					
	Nga klientë brenda territorit të Shqipërisë	Nga klientë brenda territorit të BE-së	Nga klientë jashtë territorit të BE-së dhe Shqipërisë	Numri total i ankesave të pranuar gjatë periudhës aktuale raportuese	Numri i ankesave të pagjidhura nga 3mujorët e mëparshëm raportues	
Tituj kapitali						
Tituj borxhi						
Produkte të Strukturuara						
Instrumentet e Tregut të Parasë						
Instrumenta Derivativë						

Kontratat financiare për diferencat (CFD)					
ETF					
Tjetër (specifiko produktin)					
Totali					

SHTOJCA 2: RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE DITORE

Shtojca 2/1: Raportim ditor i transaksioneve nga shoqëria komisionere/banka për shërbimin e investimit në tituj

Subjekti raportues	Vendos emrin e subjektit
Lloji i instrumentit financiar	
Identifikimi i instrumentit financiar	Kodi ISIN
Data e maturimit	Për plotësim vetëm në rastet të instrumenteve të borxhit me afat të përcaktuar maturimi
Vlera nominale	
Minimumi i Shlyerjes (minimum settlement)	Nëse ka

Identifikimi i blerësit	Për personat juridikë [NIPT] Për individë [ID]
Identifikimi i shitësit	Për personat juridikë [NIPT] Për individë [ID]
Identifikimi i personit të cilit i është transmetuar udhri	Në rastin e kryerjes së shërbimit të marrjes dhe transmetimit të urdhrave
Lloji i urdhrin	Blerje/shitje
Udhëzime të veçanta nga klienti	
Data dhe ora e tregtimit	
Kapaciteti i tregtimit	Tregtim për llogari të vet/marrje/transmetim urdhrash, etj.
Vendi i tregtimit	Treg i rregulluar/Bursë/PSHT/POT/jashtë një tregu të rregulluar (OTC)
Çmimi	
Sasia	

Monedha	
Mënyra e dorëzimit të instrumentit	Kontrata që mund të shlyhen fizikisht apo në para
Lloji i aktivitet bazë	Nëse instrumenti ka aktiv bazë
Identifikimi i aktivitet bazë	Kodi ISIN
Lloji i opsionit	Në rast se instrumenti është opsion, një identifikim të llojit të tij “call/put”
Çmimi i caktuar në kontratën e opsionit për blerjen apo shitjen e instrumentit (strike price)	
Shumëzuesi i çmimit (multiplier)	Nëse i aplikueshëm

Shënim: Sipas kësaj shtojce, shoqëria komisionere dhe banka që kryen shërbime investimi raporton transaksionet ditore me tituj, përfshirë transaksionet me tituj të Qeverisë, të realizuara në Bursë, PSHT, POT. Gjithashtu sipas kësaj shtojce raportohen edhe të gjithë transaksionet me tituj të ndryshëm nga titujt e Qeverisë jashtë një tregu të rregulluar, përfshirë transaksionet me tituj të huaj dhe Eurobondin shqiptar.

SHTOJCA 2/2**Raportim ditor i transaksioneve në Bursë/PSHT/POT**

Datë tregtimi	Kodi në platformë	Kodi ISIN	Lloji i titullit	Lloji i tregut (Zyrtar/OTC)	Lloji i transaksionit (normal/i kryqëzuar, etj)	Sasia e tregtuar	Vlera e tregtuar	Monedha	Anëtari Blerës	Për llogari të vet/Për klient	Anëtari Shitës	Për llogari të vet/Për klient

Shënim: Termi platformë nënkupton sistemin e tregtimit të Bursës, PSHT-së apo POT

SHTOJCA 3: Gabimet/anulimet në raportim

Formulari i gabimeve/anulimeve në raportim	
Informacion i Përgjithshëm	
Emri Subjektit Raportues	
Personi i Kontaktit	
Adresa e-mailit	
Detaje të gabimeve në Raportim	
Struktura përgjegjëse për monitorimin e raportimeve	
Lloji i gabimit në raportim	
Arsyet/shkaku i gabimit	
Periudha kur ka ndodhur gabimi në raportim	
Veprimet e ndërmarra për korrigjimin	
Sqaroni nëse raportet e transaksionit do të dorëzohen përsëri dhe periudha/data kur pritet të ridërgohet raporti	

SHTOJCA 4

Raportim 3 mujor i tregtimit të titujve në Bursë/PSHT/POT

Lloji i Transaksionit	Nr. i Transaksioneve	Volumi i tregtimit	Monedha e tregtimit
Për llogari të anëtarëve			
Për Klientët			
<i>Individë</i>			
<i>Persona juridik</i>			
TOTAL			

Lloji i Instrumentit Financiar (IF)	Nr. i Transaksioneve	Volumi i tregtimit	Monedha e tregtimit
IF-1			
IF-2			
IF-X			
TOTAL			

SHTOJCA 5: Depozitari Qëndror i Titujve

Raportim 3 mujor për aktivitetin si Regjistrar i titujve

Emri i Instrumenti financiar (IF)	Kodi ISIN	Gjendja			Zotëruesit e instrumentit		
		ALL	EUR	USD	Kujdestar 1	Kujdestar 2	Të tjerë
IF-1							
IF-2							
IF-3							
IF-X							
Total							

Raportim 3 mujor për aktivitetin e klerimit dhe shlyerjes së titujve

Emërtimi i Depozitarit Qëndror	
Emërtimi i sistemit të klerim - shlyerjes	
Numri i anëtarëve të klerim - shlyerjes	
Vlera e transaksioneve të shlyera gjatë periudhës raportuese	
Numri total i instruksioneve të shlyerjes	
Instruksionet e shlyerjes në total sipas llojit të instrumentit financiar	Në numër dhe vëllim
Numri total i dështimeve në shlyerje gjatë periudhës raportuese	
Shkaku i dështimit të shlyerjes dhe masat për përmirësim	Krahas shkakut, vendosni edhe një

	numër mesatar ditor të kohëzgjatjes së dështimit në shlyerje
Detaje mbi dështimet në shlyerje për pjesëmarrës	Identifikoni pjesëmarrësit me normat më të larta të dështimeve në shlyerje

Instrukcionet e shlyerjes në total sipas llojit të instrumentit financiar	Numri	Vëllimi
IF-1		
IF-2		
IF-X		
TOTAL		

SHTOJCA 6

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

Në lekë

	Periudha e mëparshme	Periudha Ushtrimore
I. Të ardhura nga shërbimet e investimit (1+2+3+4+5+6+7)		
1. Tarifa/Komisione për marrjen dhe transmetimin e urdhërave		
2. Tarifa/Komisione për ekzekutimin e urdhërave		
3. Të ardhura nga tregtimi për llogari të vet, kur ekzekutohen urdhërat e klientit		
4. Tarifa/Komisione për administrim portofoli		
5. Tarifa/Komisione për këshillim dhe rekomandim për investime		
6. Tarifa/Komisione për nënshkrim të instrumentit financiar në bazë të angazhimit në transaksion		
7. Tarifa/Komisione për nënshkrim të instrumentit financiar pa angazhim në shitje		

II. Të ardhura nga shërbimet ndihmëse (1+2)		
1. Tarifa/Komisione për ruajtjen dhe administrimin e instrumenteve financiare (kujdestaria)		
2. Tarifa/Komisione nga shërbime të tjera ndihmëse		
III. Shpenzime për aktivitetin kryesor dhe ndihmës		
1. Kosto nga transaksionet		
2. Kosto marketingu		
3. Kosto të shitjes me agjent		
4. Shpenzime të tjera të aktivitetit kryesor		
IV. Fitim/humbje nga aktiviteti kryesor dhe ndihmës (I+II – III)		
V. Të ardhura të tjera		
VI. Shpenzime që lidhen me veprimtarinë e shoqërisë (1+2+3+4+5)		
1. Kosto materiale		
2. Kosto personeli		
3. Rivlerësim i aktiveve afat gjata		
4. Axxhustim i vlerës së aktiveve afatshkurtra		

5. Kosto të tjera të veprimtarisë		
VII. Të ardhura financiare		
VIII. Shpenzime financiare		
IX. Fitim/humbje nga veprimtaria (IV+V-VI+VII-VIII)		
X. Të ardhura të jashtëzakonshme		
XI. Shpenzime të kontigjencës		
XII. Fitim/humbja e periudhës financiare para tatimit (IX +X-XI)		
XIII. Tatimi mbi fitimin		
XIV. Fitim/Humbje pas tatimit (XII- XIII)		